



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot

Data ____/____/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE ARTIKUJ USHQIMORE PER FURNIZIMIN E KOPSHTEVE, ÇERDHES DHE KONVIKTIT NE ADMINISTRIM TE BASHKISE LEZHE”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 15884000-8.

VLERA E FONDIT LIMIT: 12,412,813.60 (dymbëdhjetë milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e teteqind e trembëdhjetë pike gjashtëdhjetë) Lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kjo vlerë është përcaktuar referuar nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”*

2.2.2 Një dokument që vërteton se subjekti ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

Shenim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe të deklaruara në organet tatimore.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara dhe të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht **6 (gjashtë)** punonjës për periudhën Shkurt 2025-Prill 2025, (kjo për arsye se operatori ekonomik duhet të marrë përsipër shpërndarjen ditore të ushqimeve në katering pika të ndryshme), e vërtetuar kjo me listpagesat për periudhën e kërkuar dhe Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion fuqia punëtore e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

Nënvizojmë se kontrata në fjalë është një kontratë furnizimi e cila produktet e bukes, frutave, perimeve dhe artikujt ushqimorë me origjinë shtazore do të kryhet furnizimi periodik dhe ditor duke shpërndarë në të gjithë destinacionet e kërkuara nga AK si kopshtet, cerdhja dhe konvikti në administrim të Bashkisë Lezhë.

Gjithashtu theksojmë rëndësinë që ka furnizimi dhe shpërndarja e ushqimeve, frutave perimeve dhe produkteve të mishit dhe nevojës së personave të specializuar për secilin proces pasi duhet të njohin cilësinë e produktit duke respektuar kushtet e ambalazhimit, transportit dhe shpërndarjes së tyre pasi referuar specifikimeve teknike si dhe kërkesave të autoritetit kontraktor në

dokumentat e tenderit vërehet se ky i fundit kërkon të realizojë furnizimin periodik dhe ditor me artikuj ushqimor, fruta-perime, buke dhe artikuj ushqimore me origjine shtazore, sipas kërkeses se Autoritetit kontraktor në të gjitha kopshtet, cerdhen dhe konviktin në administrim të Bashkisë Lezhë. Thëksojmë se këto produkte kerkohen të jenë çdo ditë të freskta dhe të sigurta për konsumim.

Si përfundim kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i licensuar si më poshtë dhe të disponojë:

- License kategoria: II.1.A “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njëzë”,
- License të lëshuar nga QKL me kod II.1.B (Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njëzë).

Për të plotësuar këtë kriter për kualifikim, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencën kategoria II.1.A “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë të ushqimeve për njëzë” dhe II.1.B “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njëzë”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënnt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, po ashtu dhe në përputhje me Rekomandimin Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, publikuar në adresën www.app.gov.al.

Më anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.4 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- Çertifikate **ISO 22000:2018** “Per sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore” objekti i së ciles të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj.

Shënim: Certifikatat ISO duhet të jenë të lëshuara nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata, ISO në përputhje me % e bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Referuar natyrës së veçantë, vendndodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara dhe të disponojnë certifikatën **ISO 22000:2018 “Per sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore”** objekti i së ciles të jete në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontrate përdorimi Njësi tregtare ushqimore ose ambiente për magazinimin e artikujve të tjere ushqimore, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambjentet duhet të plotësojnë kushtet Higjeno-Sanitare.

Për të provuar kriterin e mesipër OE duhet të paraqesë:

a- kontrate qiraje/ Kontrate Bashkepunimi apo Çertifikata/Vertetim Pronesie,

b- Akt-Miratim higjeno-sanitare, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetsor (ISHSH).

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë një pike shitje në pronësi ose me qira ose të paraqesë kontrate furnizimi për buke, brenda qytetit Lezhë, ku të jete specifikuar furnizimi në vijimesi dhe të vazhdueshëm për të gjithë periudhën e marrëveshjes kuader.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Gjendja Juridike
1.	Automjet ATV (frigorifer) për transportimin e produkteve ushqimor	Cope	1	Pronësi, qira ose kontrate bashkepunimi

- Për të provuar disponimin e mjeteve të kërkuara, OE duhet të paraqesë:

a- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti, taksa, pronësia dhe foto.

b- Për të konfirmuar disponibilitetin e mjetit të marrë me qira ose kontrate bashkepunimi të paraqiten si më poshtë:

- Kontrate noteriale qiraje/ Kontrate Bashkepunimi, me afate te percaktuar te cilat do te jene ne dispozicion deri ne realizimin e kontrates.
- Kontrate noteriale qiraje/ ose kontrate bashkepunimi, te jete e shoqeruar me leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti, taksa, pronesine dhe foto).

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Po ashtu perzgjedhja e ketyre kriterëve është bërë në përputhje dhe me Rekomandimin Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, publikuar në adresën www.app.gov.al.

Referuar nevojave të Autoritetit Kontraktor, Specifikimeve Teknike dhe preventivit të mallit që kërkohet të blihet, konstatohet se kërkohet të kryhet furnizimi periodik ditor me mallra ushqimore të kopshteve, cerdhes dhe konviktit, në administrim të Bashkisë Lezhe të cilat janë shtrira në territorin e saj me vendodhje të ndryshme si dhe duke mbajtur gjithashtu në konsideratë që produktet ushqimore kategorizohen në Ushqime me origjinë shtazore dhe Ushqime me origjinë joshstazore, produktet ushqimore të fresketa të fruta-perime dhe produktet ushqimore ku për këto kategori të produkteve duhet të mbahet gjithashtu në konsideratë që për të gjithë produktet ushqimore duhet të zbatohen dispozitat e Legjislacionit për Ushqimin, Operatorët ekonomikë duhet të ketë 1 Automjet ATV (frigorifer) për transportimin e produkteve ushqimore.

Sa më sipër si përfundim këto kriterë janë vendosur në proporcion me kompleksitetin dhe vlerën e kontratës objekt prokurimi.

2.3.8 Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë nga administratori i shoqërisë për skadencën e produkteve ushqimore, e cila duhet të jetë nga 6 muaj deri në 1 vit nga momenti i levrimit të mallit si dhe furnizimin e plotë për periudhën e zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Po ashtu keto kritere jane vendosur ne përputhje dhe me Rekomandimin Nr. 10181 Prot, date 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kritereve te veçanta per kualifikim dhe specifikimet teknike per prokurimin e produkteve ushqimore”, te Agjencise se Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombetar te Ushqimit, publikuar ne adresen www.app.gov.al .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia pergjegjese ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ne te cilen theksojne se jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne specifikimet teknike argumenton se nuk ka permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT: